



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PRESIDENTI

Tiranë, më 24 tetor 2025

Shkëlqesia Juaj,

Ju falënderoj përzemërsisht për pritjen e ngrohtë të treguar ndaj meje dhe delegacionit që më shoqëronte në Molise!

Jam mirënjohës për përkujdesjen dhe mbështetjen për kishat arbëreshe në Itali, si dhe për angazhimin tuaj në shërbim të komunitetit si kontribuues në mbajtjen gjallë të besimit dhe traditës identitare arbërore.

Modeli shqiptar i harmonisë fetare është krenari dhe virtyt jo vetëm i shqiptarëve që jetojnë në Shqipëri, por, sikurse edhe ilustron modeli i jashtëzakonshëm i arbëreshëve në Itali, që respektojnë besimet e ndryshme e njëkohësisht vijojnë të ruajnë ritin e tyre fetar, edhe i shqiptarëve në mbarë botën.

Imzot, në ditët e sotme roli i institucioneve të besimit është edhe më i madh, pasi ato nuk janë vetëm ruajtëse dhe promovuese të dijes, kulturës dhe edukimit, por kanë një peshë të pazëvendësueshme në përballimin e sfidave të mëdha të modernitetit, fenomeneve të dëmtimit të komuniteteve, familjes dhe vlerave themelore njerëzore.

Përfitoj nga rasti t'Ju falënderoj dhe t'Ju shpreh konsideratën time të lartë!

Me respekt,

me respekt

Bajram Begaj
Bajram Begaj

Shkëlqesisë së Tij,
Imzot Claudio Palumbo
Ipeshkv i Dioqezës Termoli-Larino
KOMUNA TERMOLI